



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

PA1 Nr.08-265

02.10.2024

Shkup

Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 1 dhe neni 20, paragrafi (1), nënparagrafi 10¹, neni 65, paragrafët (1) dhe (4) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 69 paragrafët (1) dhe (4), neni 70, paragrafët (1), (4), (6), (9), (10), (11) dhe (12), neni 71, neni 74, neni 79, neni 80 dhe neni 81 nga Ligji i njëjtë, neni 15, paragrafi (1), nënparagrafi 1, neni 39, paragrafi (1), nënparagrafi 10 dhe neni 51, paragrafi (1) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, dhe në lidhje me Kërkesën për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës në nivel lokal, në zonën e qytetit të Negotinës nga pala e interesuar, personi fizik Goran Delov nga Negotina, me ark.nr.08-2797/1 datë 18.06.2024, Njoftimi nga Agjencia për Komunikime Elektronike pas kërkesës për informim për frekuencë të lirë për transmetim të programit në radio në nivel lokal në zonën e qytetit të Negotinës, ark.nr.0805-2033/2 datë 06.07.2024 (nr.y në ark.08-2797/4 datë 01.08.2024), Studimin për përcaktimin e arsytimit për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për radio jofitimprurëse në nivel lokal, në zonën e komunës së Negotinës (ark. nr.03-3817/1 datë 18.09.2024) dhe Konkluzionin ark.nr. 02-3960/3 datë 30.09.2024, në seancën e 37-të mbajtur më 30.09.2024, miratoi si vijon:

VENDIM
për shpallje të konkursit publik për dhënien e
lejes për transmetim në radio të shërbimit programor
të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës
në nivel lokal

1. Shpallet konkurs publik për dhënien e 1 (një) leje për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës, në nivel lokal, në zonën e komunës së Negotinës, të destinuar për popullatën lokale të zonës së komunës së Negotinës, në gjuhën maqedonase, e cila do të transmetohet përmes radiofrekuencës të përcaktuar nga Agjencia për Komunikime Elektronike të RMV-së, përkatësisht: 91,7 MHz.

Së paku 10% e programit në total të transmetuar gjatë javës duhet të jetë përmbajtje e folur, dhe së paku 70% e përmbajtjes në fjalë duhet të jetë përmbajtje me rëndësi specifike dhe relevante ose me interes për popullatën e zonës lokale – informacione të rëndësishme shërbimi, informacione për ngjarjet në zonë, përmbajtje që do të trajtojnë tema lokale në fushën e kulturës, sportit, ekonomisë, ekologjisë etj, dhe do të mundësojnë përfshirjen dhe debat të qytetarëve.

2. Leja do të jepet për një periudhë 9 (nëntë) vjeçare dhe nuk mund t'i transferohet një personi tjetër.

¹ Nënparagrafët 8 dhe 9 janë fshirë, shih: Neni 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 248/18).

3. Kandidatët për konkurs duhet të plotësojnë kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike, të përcaktuara në Ligjin për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënien e lejes për transmetim në radio (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3953/1 datë 31.10.2023, të cilat shpjegohen dhe specifikohen në dokumentacionin e konkuesit.

4. Karakteristikat teknike dhe parametrat e përcaktuar nga Agjencia për Komunikime Elektronike e RMV-së (AEK) në përputhje me Ligjin për Komunikimet Elektronike - LKE ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr.39/14, 188/14, 44/15, 193/15, 11/18 dhe 21/18 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr.98/19, 153/19 dhe 92/21) dhe Rregulloret e miratuara në bazë të saj, janë shpjeguar dhe specifikohen në dokumentacionin e konkursit dhe miratimin për shfrytëzimin e radiofrekuencës së dhënë nga AKE.

5. Aplikimet e paraqitura në konkurs, Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) do t'i vlerësojë bazuar në kriteret e mëposhtme, duke përdorur metodën e mëposhtme të pikëzimit:

1. Përfaqësimi i planifikuar i programit të prodhuar nga vetë transmetuesi (in-house production) dhe prodhimi i veprave audio maqedonase		17 pikë
<ul style="list-style-type: none"> • përfaqësimi i planifikuar i programit të prodhuar nga vetë transmetuesi (in-house production), gjatë javës <ul style="list-style-type: none"> - deri në 50% të pjesës folëse të programit - mbi 50% të pjesës folëse të programit 	10 pikë	
	17 pikë	
2. Cilësia, zhanri dhe diversiteti tematik i përmbajtjeve		17 pikë
<ul style="list-style-type: none"> - 3 (tre) lloje programesh nga pjesa folëse e programit 	10 pikë	
<ul style="list-style-type: none"> - mbi 3 (tre) lloje programesh nga pjesa folëse e programit 	17 pikë	
3. Përfaqësimi i programeve që nxisin zhvillimin dhe ruajtjen e kulturës kombëtare		17 pikë
<ul style="list-style-type: none"> • programe që nxisin zhvillimin dhe ruajtjen e kulturës kombëtare, të transmetuara çdo vit <ul style="list-style-type: none"> - deri në 15 orë gjatë vitit - mbi 15 orë gjatë vitit 	5 pikë	
	8 pikë	
<ul style="list-style-type: none"> • transmetimi i muzikës instrumentale nga autorë maqedonas, muzikë vokale dhe/ose vokalo-instrumentale në gjuhën(t) në të cilën do të transmetohet pjesa folëse e programit, gjatë ditës. <ul style="list-style-type: none"> - deri në 30% të muzikës totale të transmetuar - mbi 30% e totalit të muzikës së transmetuar 	5 pikë	
	9 pikë	
4. Paraqitja e informacionit dhe e përmbajtjeve me rëndësi për grupin e synuar nga zona ku do të transmetohet shërbimi programor, gjatë javës.		17 pikë
<ul style="list-style-type: none"> - nga 70% deri në 80% të pjesës folëse të programit 	10 pikë	
<ul style="list-style-type: none"> - mbi 80% e pjesës folëse të programit 	17 pikë	

5. Numri dhe struktura e të punësuarve të nevojshëm për kryerjen e veprimtarisë (së paku 1 person pjesëmarrës në krijimin e programit, i punësuar në marrëdhënie të rregullt pune me kohë të plotë pune)		4 pikë
- deri në 1 të punësuar	1 pikë	
- mbi 1 të punësuar	4 pikë	
6. Kushtet teknike për prodhimin e programeve		7 pikë
7. Koha e ofruar e programit të transmetimit ditor		8 pikë
- nga 4 deri në 10 orë	4 pikë	
- mbi 10 orë	8 pikë	
8. Kushtet hapësinore për kryerjen e veprimtarisë		7 pikë
9. Aftësia financiare për të kryer aktivitetin dhe garancitë e ofruara		4 pikë
10. Afati i ofruar për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë		2 pikë
- deri në 3 muaj nga dita e dhënies së lejes	2 pikë	
- mbi 3 muaj nga dita e dhënies së lejes	1 pikë	
	Në total	100 pikë

6. Për lejen për transmetim në radio paguhet kompensim vjetor për çdo vit aktual, duke filluar nga data e dhënies së lejes, në llogari të Agjencisë, në afati prej 30 ditësh nga dita e pranimit të faturës nga Agjencia.

Mënyra e llogaritjes, faturimit dhe pagesës së kompensimit për leje përcaktohet nga Agjencia në pajtim me nenin 80 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe në pajtim me Rregulloren për procedurat e punës financiare dhe kontabël të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (“Gazeta Zyrtare e RM-së”, nr.185/14), Rregulloren për formatet e shërbimeve programore të radiodifuzerëve (“Gazeta Zyrtare e RM-së”, nr.172/14) dhe Rregulloren për zonat e transmetimit të shërbimeve programore televizive dhe radio (“Gazeta Zyrtare e RM-së”, nr.172/14).

7. Për shfrytëzimin (përdorimin) e radiofrekuencave paguhet kompensim vjetor në pajtim me LKE dhe Rregulloren për mënyrën e llogaritjes së kompensimit vjetor për shfrytëzimin e radio frekuencave, të Agjencisë për komunikime elektronike (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr.192/21).

Kompensimi për shfrytëzimin e radio frekuencave paguhet në llogarinë e Agjencisë për Komunikime Elektronike të RMV-së për çdo vit aktual paraprakisht duke filluar nga data e vlefshmërisë së miratimit për shfrytëzimin e radiofrekuencave.

8. Për përcaktimin e frekuencës së transmetimit, mikrolokacionit, fuqisë maksimale efektive të rrezatuar (ERP), drejtimit të sistemit antenor, si dhe për parametra të tjerë teknikë që nuk përcaktohen me këtë Vendim dhe për dokumentacionin e konkursit, kandidatët janë të detyruar (pas marrjes së dokumentacionit nga Agjencia dhe pranimit të konfirmimit nga Agjencia për dokumentacionin e marrë) të kontaktojnë me Agjencinë për Komunikime Elektronike të RMV-së, ku do të marrin parametrat e detajuar teknikë, të cilët janë pjesë përbërëse e dokumentacionit të konkursit (tenderit) dhe sipas të cilit do të duhet të përgatitet raporti teknik për pjesën e transmetimit.

Aplikimi i kandidatëve në Agjencinë për Komunikime Elektronike duhet të jetë me të njëjtin titull/emër si në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

9. Kandidatët për Konkurs dorëzojnë Aplikimin në formular të veçantë, ku formën dhe përmbajtjen e të cilave e përcakton Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, e cila publikohet në ueb faqen e Agjencisë.

Dokumentacioni i konkursit dhe formulari-aplikimi (fletëparaqitja), mund të merren në arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, Pallati "Panko Brashnarov", rr."Makedonija" nr.38, Shkup, çdo ditë pune nga ora 8:00 deri në orën 16:00.

Për dokumentacionin paguhet kompensim në shumë prej 60.000,00 (gjashtëdhjetë mijë) denarë në xhiro llogarinë: 300000000618023 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, Banka depozitues: Komercialna banka SHA Shkup.

10. Aplikimi paraqet në zarf të mbyllur në Agjenci, Pallati " Panko Brashnarov", rr." Makedonija" nr.38, Shkup, e shënuar në këtë mënyrë², përkatësisht:

- në pjesën e sipërme të këndit majtas të zarfit të mbyllur të shkruhet "MOS HAP" ,
- në mesin e zarfit të mbyllur të shkruhet " Aplikim për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës në nivel lokal, në zonën e komunës së Negotinës".

Formularët dhe Shtojcat për Aplikim për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës në nivel lokal, në zonën e komunës së Negotinës, duhet të jenë të sistemuara sipas renditjes dhe numrit rendor të formularit, domethënë si bashkëngjitje e aplikacionit, nga ku në çdo shtojcë të aplikimit, në pjesën e parë të këndit të djathtë sipër të fletës të vendoset numri rendor përkatës(Shembull : Shtojca nr.____).

Aplikacioni, me dokumentacionin shoqërues nga neni 73 paragrafi (3) i LSHMAAV, paraqet në 2 (dy) kopje (origjinale dhe kopje).

11. Aplikimi mund të dorëzohet me postë rekomanduese ose me dorëzim në arkivin e Agjencisë

12. Aplikimi paraqitet në afati prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh.

Afati për paraqitjen e aplikimeve fillon nga dita e parë pas ditës së publikimit të këtij Vendimi në " Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Aplikimet dorëzohen në afatin e përcaktuar me këtë Vendim në mënyrën, formën, numrin e kopjeve dhe me përmbajtje të parashikuar në dokumentacionin e Konkursit.

Aplikimet e kandidatëve që nuk e kanë paguar kompensimin për dokumentacionin,që do ta dorëzojnë pas skadimit të afatit të përcaktuar me këtë Vendimi, aplikimet e pa kompletuara (të cilat nuk do të përmbajnë të gjithë dokumentet dhe bashkëngjitjet sipas Aplikimit), Aplikimet e

² Nëse paraqitësit e aplikimeve për pjesëmarrje në konkurs publik nuk përmbushin kushtet e përcaktuara në pikën 10 të këtij vendimi, Agjencia nuk merr përgjegjësi për vonesën ose hapjen e parakohshme të Aplikimit.

kompletuara në mënyrë të parregullt, si dhe aplikimet që nuk do të dorëzohen në 2 (dy)) kopje (originale dhe kopje), nuk do të shqyrtohen.

Informacion plotësues, në lidhje me konkursin publik të shpallur, mund të mirret nga personat e mëposhtëm:

- për konceptin programor: mr. Ognen Nedelkovski telefon celular: 072/212-686 dhe e-mail adresë: o.nedelkovski@avmu.mk; Rubin Taleski telefon celular: 075/452-523 dhe e-mail adresë: r.taleski@avmu.mk;

- për strukturën pronësore dhe kushtet kadrovike: Katerina Donevska telefon celular: 075/452-543 dhe e-mail adresë: k.mitre@avmu.mk;

- për kushtet teknike dhe hapësinore: mr. Argjend Xhelili telefon celular: 070/327-991 dhe e-mail adresë: argjend.xhelili@avmu.mk;

- për kushtet financiare: Goran Radunović telefon celular: 071/223-219 dhe e-mail adresë: g.radunovic@avmu.mk; Vesna Simonovska telefon celular: 076/ 344-198 dhe e-mail adresë: v.simonovska@avmu.mk dhe

- për të dhëna të përgjithshme dhe çështje juridike: mr. Ivona Mufisheva telefon celular: 076/496-803 dhe e-mail adresë: i.mufiseva@avmu.mk dhe mr. Biljana Paneva-Parleeva, telefon celular: 076/344-194 dhe e-mail adresë: b.parleeva@avmu.mk.

13. Aplikimet që do të paraqiten në këtë konkurs publik, do të hapen publikisht, në selinë e Agjencisë, Pallati "Panko Brashnarov", rr. "Makedonija" nr.38, Shkup, një javë pas skadimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve, të përcaktuar në pikën 12 të këtij vendimi.

Informacioni për ditën dhe orën e hapjes publike do të publikohet në ueb-faqen e Agjencisë: www.avmu.mk.

14. Vendimi për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës, në nivel lokal, në zonën e komunës së Negotinës, destinuar për popullatën vendase të zonës së komunës Negotinë, në gjuhën maqedonase, do të miratohet në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e hapjes publike të aplikacioneve, të përcaktuara në pikën 13 të këtij vendimi.

Kandidatët e konkursit do të njoftohen për vendimin për dhënien e lejes, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e miratimit të tij.

15. Ky vendim do të publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, si dhe së paku në 2 (dy) gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarët të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe hyn në fuqi nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

A r s y e t i m

Në adresën zyrtare të e-mailit (contact@avmu.mk) të Agjencisë më 18.06.2024, nga i interesuari, personi fizik Goran Delov nga Negotino, është paraqitur kërkesë për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës në nivel lokal, në zonën e qytetit të Negotinës, ark.nr.08-2797/1 datë 18.06.2024.

Menjëherë pas dorëzimit të kërkesës në fjalë, Agjencia me datë 19.06.2024, drejtuar personit fizik Goran Delov nga Negotino, ka dorëzuar Njoftimin ark.nr.08-2797/2 datë 19.06.2024, me të cilin parashtruesi i kërkesës është informuar për veprimet që do të ndërmarrë Agjencia me rastin e kërkesës në fjalë, si dhe i është dhënë shpjegim për procedurën e dhënies së lejes për transmetim në radio Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës të përcaktuar në LSHMAAV. Njëkohësisht në njoftim thuhet se duke pasur parasysh se kërkesa në fjalë i referohet shpalljes së konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimi programor, përmes resursi të kufizuar natyror - radiofrekuencë, Agjencia pas zgjedhjes së Qeverisë së RMV-

së pas përfundimit të zgjedhjeve Presidenciale dhe Parlamentare në RMV në vitin 2024, në përputhje me nenin 70, paragrafi (1) të LSHMAAV, drejtuar Agjencisë për Komunikim e Elektronike (AKE), do të paraqesë kërkesë me qëllim të marrjes së informacionit për frekuencë të lirë të mundshme në zonën e komunës Negotinë, si dhe parametrat bazë teknike në bazë të të cilave do të përpilohet zgjidhja teknike për transmetim të programit në radio në nivel lokal, në të njëjtën zonë.

Duke pasur parasysh se në përputhje me konkluzionet e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, ark.nr.08-2163/1 datë 11.05.2024 dhe ark.nr.10-3082/1 datë 30.05.2024 dhe Vendimi për zgjedhjen e Qeverisë së RMV-së, ark.nr.08-3127/1 datë 23.06.2024 ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.132/24), Zgjedhjet Presidenciale dhe Parlamentare të RMV-së në 2024 kanë përfunduar zyrtarisht, Agjencia në përputhje me nenin 70, paragrafi (4) të LSHMAAV-së, i është drejtuar me shkresë – Kërkesë AKE (ark.nr.08-2797/3, datë 02.07.2024), për të dhënë informacion nëse ka radiofrekuencë të lirë në zonën e qytetit të Negotinës dhe nëse ka, për paraqitjen e parametrave bazë teknike në bazë të të cilave do të përpilohet zgjidhja teknike për transmetim të programit në radio në këtë zonë. AKE, me datë 01.08.2024 me Shkresë ark.nr.0805-2033/2 datë 26.07.2024 (nr.y në ark.08-2797/4 datë 01.08.2024), informoi se shërbimi profesional i saj kanë kryer analizë të ndarjeve ekzistuese në zonën e kërkuar, llogaritja e softuerit të përhapjes së radios, si dhe matjet në rajonin e qytetit të Negotinës, në bazë të të cilave është arritur rezultati se për zonën e shërbimit - qytetin e Negotinës ekziston mundësia e përcaktimit të frekuence të re. Për përgatitjen e specifikacionit të tenderit për tenderin publik, përkatësisht dokumentacionit të konkursit për dhënien e lejes për kryerjen e veprimtarisë transmetuese – radio në nivel vendor, AKE informoi se mund të shfrytëzohen këto karakteristika : "Vendndodhja e transmetuesit: Serta; fuqia efektive e rrezatimit: 300 W dhe Frekuenca: 91.7 MHz".

Në nenin 70 paragrafi (4) të LSHMAAV është parashikuar se nëse në pajtim me Planin për dhënien dhe shfrytëzimin e radiofrekuencave, përcaktohet se ka radiofrekuenca të lira, Agjencia do të përgatisë Studim me të cilin do të përcaktojë arsyetimin për shpallje të konkursit publik, dhe veçanërisht nga aspekti i përmbushjes së qëllimit të këtij ligji, si dhe nga aspekti i nevojave të publikut (audiencës).

Rrjedhimisht, nga sa mësipër, Agjencia bërë Studim për përcaktimin e arsyeshmërisë për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për radio jofitimprurëse në nivel lokal, të zonës së komunës së Negotinës (ark.nr.03-3817/1 datë 18.09.2024), e cila është publikuar në ueb faqen e Agjencia me datë 18.09.2024³. Në përputhje me studimin, radiostacionet jofitimprurëse janë shumë të rëndësishme për sigurimin e pluralizmit mediatic. Përveç ekzistencës së sektorit publik dhe privat, me rëndësi të veçantë është që të ofrohen kushte për zhvillimin e tyre e ashtuquajtur sektor i tretë, për shkak se mediat në komunitet merren me tema për të cilat zakonisht nuk ka hapësirë në programet e mediave komerciale. Duke mbuluar tema që janë të rëndësishme për komunitetin, këto media kontribuojnë në zhvillimin social, ekonomik dhe kulturor të komunitetit, inkurajonë debatin, lehtësojnë pjesëmarrjen e anëtarëve të komunitetit, dhe lejojnë që zërat e pjesëve të marginalizuara të komunitetit të dëgjohen. Ata përfaqësojnë një plotësues dhe alternativë për sektorin e medias komerciale dhe publike, dhe karakteristikat kryesore të tyre janë përgjegjësia ndaj komunitetit, përfshirja e qytetarëve dhe fokusi në temat dhe çështjet lokale. Gjetjet e studimit të cituar treguan se ka arsyetim për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për radio jofitimprurëse në nivel lokal në zonën e Negotinës dhe se: target grup i transmetuesit duhet të jetë popullata lokale e zonës së Komunës së Negotinës; gjuha në të cilën do të transmetohet pjesa folëse e shërbimit programor të jetë maqedonishtja; së paku 10% e totalit të programit të transmetuar gjatë javës duhet të jetë përmbajtje me fjalë; së paku 70% e përmbajtjes folëse duhet të jetë përmbajtje që ka rëndësi specifike dhe relevante ose interes për popullatën e zonës lokale - informacione të rëndësishme shërbimi, informacione për ngjarjet në zonë, përmbajtje që do të trajtojnë tema lokale në fushën e kulturës, sportit, ekonomisë, ekologjisë e të tjera, dhe do të mundësojë përfshirjen dhe debatin e qytetarëve.

³ <https://avmu.mk/wp-content/uploads/2024/09/Studim-për-përcaktim-të-arsyetimit-për-shpallje-të-konkursit-publik-për-radio-jofitimprurëse-Negotin.pdf>

Rrjedhimisht nga sa mësipër dhe duke marrë parasysh se në pajtim me Planin për ndarjen dhe shfrytëzimin e radiofrekuencave u përcaktua se ka frekuencë të lirë për zonën e shërbimit - qyteti i Negotinës, dhe sipas Studimit, ark.nr.03-3817/1 datë 18.09.2024, u përcaktua arsyetimi për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për radio jofitimprurëse në nivel lokal nivel , në zonën në komunës së Negotinës, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 1 dhe neni 20, paragrafi (1), nënparagrafi 10, neni 65 paragrafët (1) dhe (4) të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 69, paragrafët (1) dhe (4), nenin 70, paragrafët 1, 4, 6, 9, 10, 11 dhe 12, neni 71, neni 74, neni 79, neni 80 dhe neni 81 nga Ligji i njëjtë, neni 15, paragrafi (1), nënparagrafi 1, neni 39 paragrafi (1), nënparagrafi 10 dhe neni 51, paragrafi (1) të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Konkluzionin ark.nr.02-3960/3 datë 30.09.2024, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale në seancën e 37-të mbajtur më 30.09.2024, ka miratuar Vendim si në dispozitiv, i cili do të publikohet në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, në ueb faqen e Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, si dhe në 2 (dy) gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarët të Republikës së Maqedonisë së Veriut , i cili hyn në fuqi nga dita e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**